



Prokurimi publik

Ngritja e organeve të shqyrtimit të prokurimit publik

PËRMBAJTJA

- [Rëndësia e sistemit të shqyrtimit dhe mjeteve juridike](#)
- [Modelet kryesore institucionale](#)
- [Kërkesat kryesore të një organi të specializuar të shqyrtimit](#)
- [Ankesat administrative pranë autoritetit/subjektit kontraktues](#)
- [Statusi dhe pavarësia e një organi të specializuar të shqyrtimit](#)
- [Çështje të tjera të rëndësishme praktike](#)
- [Informacion i mëtejshëm](#)

Autorizuar për botim nga Karen Hill, Drejtuese e Programit të SIGMA-s

Rëndësia e sistemit të shqyrtimit dhe mjeteve juridike

Objekti kryesor i sistemit të shqyrtimit të ankesave të prokurimeve publike dhe të mjeteve juridike është për të zbatuar aplikimin praktik të legjislacionit të prokurimit publik duke siguruar që të korrighohen shkeljet e këtij legjislacioni dhe gabimet e qëllimshme apo të paqëllimshme të autoriteteve/subjekteve kontraktore. Sistemi i shqyrtimit të prokurimit dhe mjeteve juridike që funksionon mirë është në interes të të gjitha palëve të interesuara - operatorëve ekonomikë dhe autoriteteve/subjekteve kontraktore, si dhe të publikut të gjerë.

Sistemet e shqyrtimit të prokurimit publik dhe të mjeteve juridike të Shteteve Anëtare krijohen dhe zhvillohen në bazë të kërkesave specifike të Direktivave të Mjeteve Juridike,¹ të Traktatit,² dhe të praktikës gjyqësore të Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian (GJED).

Sistemi i shqyrtimit dhe i mjeteve juridike duhet t'u sigurojë ofertuesve të dëmtuar dhe kandidatëve mjetet juridike, të cilat duhet të jenë:

- Të shpejta
- Efektive
- Transparente
- Jodiskriminuese.

Edhe pse Direktivat e Mjeteve Juridike u drejtohen shteteve anëtare, vendet candidate dhe disa vende partnere të Bashkimi Evropian (BE) janë duke zhvilluar mjete juridike efikase të mira dhe sisteme të reja të cilat janë të bazuara në parimet e përgjithshme të nxitura nga Direktivat e Mjeteve Juridike. Ky Udhëzim synon të japë udhëzime të përgjithshme - në mënyrë të veçantë për hartuesit e politikave në këto vende - për një nga elementet më të rëndësishme për t'u marrë në konsideratë gjatë zhvillimit dhe implementimit të një sistemi të mjeteve juridike: krijimi i organit (ose organeve) të shqyrtimit.

Udhëzimi jep së pari një përshkrim të modeleve kryesore institucionale në BE, pa u përpjekur për të vlerësuar avantazhet/disavantazhet përkatëse të tyre ose për të rekomanduar ndonjë organizim institucional. Ai thekson kërkesat kryesore të parashikuara në Direktivat e Mjeteve Juridike dhe në praktikën gjyqësore të GJED-së për organet e "specializuara" të shqyrtimit. Pjesët e fundit të Udhëzimit trajtojnë kryesisht aspekte të praktikës së mirë, të tilla si rrugët e sigurimit të pavarësisë së organeve të shqyrtimit dhe aspektet që kanë të bëjnë me çështje të tjera të rëndësishme të përfshira në krijimin e një organi të shqyrtimit.

¹ Direktiva 89/665/KEE mbi koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative në lidhje me zbatimin e procedurave të shqyrtimit për dhënien e kontratave publike të furnizimit dhe të punëve publike, 21 dhjetor 1989; Direktiva 92/13/KEE që koordinon ligjet, rregulloret dhe dispozitat administrative në lidhje me zbatimin e rregullave të Komunitetit mbi procedurat e prokurimit të subjekteve që veprojnë në sektorët e ujit, energjisë, transportit dhe telekomunikacionit, 25 shkurt 1992; Direktiva 2007/66/KE që ndryshon Direktivat e Këshillit 89/665/KEE dhe 92/13/KEE në lidhje me përmirësimin e efektivitetit të procedurave të shqyrtimit që kanë të bëjnë me dhënien e kontratave publike, 11 dhjetor 2007.

² Traktati për Funkcionimin e Bashkimit Evropian - version i konsoliduar i Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian, *Gazeta Zyrtare të Bashkimit Evropian*, C 326, 26 tetor 2012. Në Udhëzimin e Prokurimit Traktati referohet si "TFBE" ose "Traktati".

Modelet kryesore institucionale

Ka një numër modelesh të ndryshme për krijimin e kuadrit të mjeteve juridike institucionale si dhe qasje të ndryshme për zbatim e tyre në Shtetet Anëtare.³ Kjo shumëllojshmëri ekziston për shkak të diversitetit të traditave ligjore kombëtare. Prandaj është e vështirë të pohojmë se një model është më i mirë se një tjetër. Që të gjitha Shtetet Anëtare gëzojnë autonomi institucionale, secili është i lirë të zgjedhë opsionin më të përshtatshëm për të siguruar shqyrtim efektiv të kontratave të prokurimit publik. Shtetet Anëtare nuk janë të detyruara që të ndryshojnë strukturën e tyre institucionale për efekt të implementimit, aplikimit dhe zbatimit të së drejtës së BE-së, por ato mund të përdorin kanalet kombëtare dhe mekanizmat që janë tashmë të miratuara, me kusht që ato të jenë në përputhje me të drejtën e BE-së. Në të njëjtën kohë, asgjë nuk e pengon një Shtet Anëtar që të krijojë organe të reja të specializuara administrative me autoritetin për të siguruar mjete juridike.

Për aq sa Shtetet Anëtare sigurojnë shqyrtimin efektiv të kontratave të prokurimit publik, ato janë të lira që t'ia kalojnë funksionet e mjeteve juridike tek çdonjëri prej organeve të mëposhtme:

- Gjykatat e rregullta;
- Organet administrative të specializuara; ose
- Një kombinim i të dyjave.

Direktivat e Mjeteve Juridike sigurojnë që ankesat mund të paraqiten pranë "organeve të veçanta përgjegjëse për aspekte të ndryshme të procedurës". Në shumicën e Shteteve Anëtare, modeli i zgjedhur është një kombinim i organeve të ndryshme të shqyrtimit që janë përgjegjës për aspekte të ndryshme të shqyrtimit. Për shembull, është gjë e zakonshme që pretendimet të cilat përfshijnë dëme të shqyrtohen në gjykatat e rregullta. Megjithatë, në disa juridiksione, organi i specializuar i shqyrtimit të prokurimit mund të shqyrtojë ankesat pa vendosur mbi dëmet, nëse kërkohet dëmshpërblim. Shpesh, përfundimi i kontratës është pika në të cilën ndahen të dy rrugët në një sistem të tillë.

Në lidhje me **gjykatat e rregullta**, Direktivat e Mjeteve Juridike nuk kërkojnë që shqyrtimi të kryhet në gjykatat civile ose administrative. Sipas rregullave procedurale në çdo vend, mund të parashikohet njëri opsion ose të dy prej tyre.

Në Austri, Belgjikë, Francë, Irlandë, Lituani, Holandë, Portugali, Suedi dhe në Mbretërinë e Bashkuar, shqyrtimi i vendimeve të prokurimit publik është detyrë vetëm e gjykatave të rregullta.

Belgjika bën një dallim të qartë në mes të kontratave që mbulohen nga Direktiva 2004/18/KE dhe kontratat që mbulohen nga Direktiva 2004/17/KE. Gjykatat administrative belge merren me mosmarrëveshjet e prokurimit publik në lidhje me kategorinë e parë të kontratave, ndërkohë që gjykatat civile merren me mosmarrëveshjet që përfshijnë kontratat e kategori së dytë.

Në shtetet e tjera anëtare, juridiksioni varet nga natyra (private apo administrative) e kontratës përkatëse. Franca është një shembull ku të dyja, gjykatat civile dhe administrative, janë të përfshirë në procesin e shqyrtimit: gjykatat civile shqyrtojnë vendimet e prokurimit të shërbimeve në pronësi private.⁴

³ Informacioni në këtë Udhëzim për modelet kryesore institucionale është marrë nga Sistemi i Shqyrtimit të Prokurimit Publik dhe i Mjeteve Juridike në Bashkimin Evropian, Dokumenti i SIGMA-s Nr. 41 (2007), i cili nuk është përditësuar. Për informacione më të fundit shih gjithashtu: [Efikasiteti ekonomik dhe efektiviteti ligjor i procedurave të rishikimit dhe e mjeteve juridike për kontratat publike – Fishat përfundimtare të studimit të vendit \(MARKT/2013/072/C\)](#).

⁴ Shembujt ilustrues të përdorur në këtë Udhëzim të pozicioneve dhe praktikave ligjore në Shtetet Anëtare janë marrë nga Dokumenti i SIGMA-s Nr. 41 (shih shënimin fundor 3 më sipër).

Dallimi thelbësor në mes të modeleve të ndryshme ka të bëjë me nivelin e organit të shqyrtimit të shkallës së parë. Shkalla e parë i referohet në disa raste gjykatës administrative të shkallës më së ulët të dhe në raste të tjera në një shkallë më të lartë të juridiksionit. Niveli i shkallës së parë mund të ketë implikime sa i përket kostos, shpejtësisë dhe afërsisë me palët. Procedura në një gjykatë të nivelit të lartë mund të jetë e kushtueshme, kërkon kohë dhe mund të jetë gjeografikisht larg nga vendi në të cilin është realizuar kontrata e prokurimit. Këta faktorë mund t'i pengojnë ofertuesit për të bërë ankesa. Në të kundërt, procedura në një gjykatë të nivelit të ulët mund të jenë më pak e shtrenjtë, më e shpejtë, dhe më afër rajonit të zbatimit të kontratës së prokurimit; nga ana tjetër, këtij organi mund t'i mungojë përvoja dhe ekspertiza.

Organet e specializuara të shqyrtimit të prokurimit publik ekzistojnë në rreth gjysmën e të gjitha Shteteve Anëtare. Këto organe janë zakonisht të një natyre jo-gjyqësore ose kuazi-gjyqësore (domethënë, të ngjashme me gjykatat në kuptim të TFBE-së, neni 267) dhe kanë funksionin e një organi të shqyrtimit të shkallës së parë. Me disa përjashtime, vendimet e organit të specializuar të shqyrtimit janë të detyrueshme, edhe pse ato janë subjekt i apelimit në gjykatat civile ose administrative, të cilat mund të anulojnë ose të ndryshojnë vendimin në shkallë të dytë.

Në shumë shtete anëtare shkalla e dytë është instanca e fundit, por në një numër Shtetesh Anëtare kanë shkallë të tretë të shqyrtimit gjyqësor, p.sh., Estonia, Letonia, Lituania, Holanda, Sllovakia, Suedia dhe Mbretëria e Bashkuar.

Shumë përparësi të rëndësishme rekomandojnë krijimin e organeve të specializuara të shqyrtimit të prokurimit, veçanërisht në vendet kandidatë dhe kandidatë potenciale, si dhe në çdo vend tjetër të interesuar në zbatimin e një sistemi efikas të shqyrtimit:

- Procedura zakonisht është më e thjeshtë dhe më e shpejtë se në gjykatat e rregullta. Këto karakteristika sigurojnë kushtet për plotësimin më të mirë të kriteve të "shpejtësisë", e cila duhet të jetë një tipar specifik i sistemit të mjeteve juridike.
- Anëtarët e specializuar të organit të shqyrtimit merren ekskluzivisht me rastet e prokurimit. Si rezultat, ata kanë mundësi që të fitojnë ekspertizë të specializuar shumë shpejt dhe të njihen me procedurat e dhënies së kontratës dhe çështje të tjera të lidhura.
- Kostot e paraqitjes së një ankesë para një organi të specializuar të shqyrtimit të prokurimit publik janë shpesh më të ulëta se kostot e shqyrtimit nga ana e një gjykate të rregullt, për shkak të kohëzgjatjes së procedurës dhe të nevojës për përfaqësim ligjor në gjykatat e rregullta.

Kërkesat kryesore të një organi të specializuar të shqyrtimit

Edhe pse një organ i specializuar i shqyrtimit të prokurimit publik është zakonisht jogjyqësor, ai mund të ketë karakter gjyqësor.

Karakter i gjyqësor: Jurisprudenca e GJED-së⁵ ka përcaktuar kërkesat kryesore në bazë të të cilave organi përgjegjës për sigurimin e mjeteve juridike duhet të konsiderohet si organi që ka karakter gjyqësor (ose kuazi-gjyqësore). GJED-ja merr parasysh një sërë faktorësh, duke përfshirë edhe faktin nëse organi është i krijuar me ligj apo jo, nëse është i përhershëm si dhe nëse juridiksioni i tij është i detyrueshëm apo jo, procedura e tij është në mes të palëve (*inter partes*), ai zbaton sundimin e ligjit dhe është i pavarur.

⁵ Një nga çështjet më të rëndësishme të GJED-së është C-54/96, *Dorsch Consult GmbH v. Bundesbaugesellschaft Berlin*. Shih edhe C-203/14 *Consorti Sanitari del Maresme v. Corporacio de Salut del Maresme i la Selvafor* që përben diskutimin më të fundit të kësaj çështje.

- **Organi është krijuar me ligj.** Në shumë shtete anëtare, krijimi i organit të shqyrtimit është parashikuar në një kapitull dedikuar ligjit të prokurimit publik (LPP). Një ligj i veçantë që mbulon vetëm aspektin institucional, mund të jetë një zgjidhje e mirë. Dispozitat ligjore duhet të rregullojnë aspekte të ndryshme duke siguruar funksionalitetin e organit, duke përfshirë për shembull, dispozita në lidhje me kompetencat e organit të shqyrtimit, emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të tij, kualifikimet e kërkuara për anëtarët e organit të shqyrtimit, dispozitat për konfliktin e interesave, sistemin e paracaktuar për shpërndarjen e çështjeve, dhe kërkesat procedurale.
- **Organi i shqyrtimit është i përhershëm.** Organi nuk është i ngritur në baza *ad hoc*. Anëtarët e tij qëndrojnë në pozicionin e tyre për një periudhë të caktuar dhe trajtojnë çështjet në bazë të një sistemi të paracaktuar të shpërndarjes.
- **Juridiksioni i organit të shqyrtimit është i detyrueshëm.** Çdo vendim/përcaktim i bërë nga organi i shqyrtimit duhet të jetë i zbatueshëm. Në veçanti, organit i janë dhënë kompetencat:
 - Për të vendosur masa të përkohshme me qëllim korrigjimin e shkeljes apo parandalimin e dëmtimit të mëtejshëm. Këto masa të përkohshme përfshijnë pezullimin, ose masa për të siguruar pezullimin e procedurës së tenderit ose zbatimin e çdo vendimi të marrë nga autoriteti kontraktor/njësia ekonomike;
 - Për të anuluar ose për të siguruar anulimin e çdo vendimi që është marrë në mënyrë të paligjshme. Ky anulim përfshin heqjen e specifikimeve diskriminuese teknike, ekonomike apo financiare në njoftimin e tenderit ose në dokumentacionin e tenderit.

Kompetenca për të dhënë dëmshpërblim nuk është kusht i detyrueshëm, ndërkohë që rekomandohet që kjo kompetencë t'i jepet gjykatave më të larta.

Një përjashtim mund të vërehet në **Danimarkë**, ku Bordi i Ankesave është i autorizuar për të dhënë dëmshpërblim. Megjithatë, vlen të përmendet se numri i ankesave në Danimarkë është shumë i ulët, dhe ngarkesa e punës nuk ndikon në kërkesën për të siguruar shpejtësinë e mjeteve juridike. Kompensimi i dëmeve i nënshtrohet një vendimi paraprak mbi thelbin e çështjes, p.sh. një vendim që mbështet ankesën kundër një shkelje të rregullave në fuqi të prokurimit publik. Vlerësimet e dëmeve përcaktohen në përputhje me parimet e përgjithshme të së drejtës daneze. Varësisht nga rrethanat e rastit, dëmet mund t'i shtohen kostove të tenderimit ose fitimeve të humbura.

- **Procedura para organit të shqyrtimit është në mes të palëve (*inter partes*).** Në të gjitha rastet duhet të respektohen rregullat e përgjithshme të kundërshtimit. Të gjitha palëve të interesuara u jepet mundësi e mjaftueshme për të paraqitur faktet dhe provat, dhe secila palë duhet të ketë të drejtën për t'u përgjigjur apo për të kundërshtuar të gjitha provat dhe argumentet e paraqitura nga pala tjetër. Seancat dëgjimore sigurojnë një mundësi të mirë për të dyja palët që ato të trajtojnë qëndrimet e njëra-tjetrës, ndërkohë që një alternativë e pranueshme është që palët të lejohen të paraqesin deklarata me shkrim gjatë procedurës së shqyrtimit. Të dyja palët duhet të kenë akses në procedurat e shqyrtimit të dosjes, me përjashtim të aksesit në informacionet konfidenciale.

Si parim, seancat e **Bordit të Arbitrazhit të Prokurimeve Publike të Hungarisë** organizohen në një sesion të hapur, por Këshilli mund të vendosë që t'i kryejë procedurat *në formë të mbyllur* kur kjo privatësi do të jetë e nevojshme për arsye të sekretit shtetëror, profesional ose të biznesit. Në varësi të disa përjashtimeve, të cilat zakonisht ekzistojnë për shkak të sekreteve të biznesit, aksesit në dosjen e prokurimit është i garantuar plotësisht për të gjitha palët e përfshira.

- **Organi i shqyrtimit zbaton sundimin e ligjit.** Kur merr vendime, organit të shqyrtimit i kërkohet të zbatojë dispozitat që rregullojnë dhënien e kontratave publike, të cilat janë të përcaktuara në direktivat përkatëse të prokurimit dhe në legjislacionin kombëtar të miratuar për transpozimin e këtyre direktivave. Kjo kërkesë është e lidhur ngushtë me kërkesën e parë (organi është i krijuar me ligj), sepse fakti se rregullat e përgjithshme procedurale që sigurojnë funksionalitetin e organit, janë vetë të parashikuara në ligj mund të jetë një argument i fortë që tregon se organi e përmbush këtë kërkesë.
- **Organi i shqyrtimit është i pavarur.** Kjo kërkesë mbulon shumë aspekte - institucionale dhe financiare -, por parimi kryesor është se organi i shqyrtimit kryen detyrën e tij në mënyrë të pavarur dhe nën përgjegjësinë e tij, dhe se anëtarët e tij i nënshtrohen vetëm respektimit të ligjit (më shumë detaje janë paraqitur në seksionin tjetër të këtij Udhëzimi).

Karakter i jo-gjyqësor: Në rastet kur organet përgjegjëse për procedurat e shqyrtimit nuk kanë karakter gjyqësor, dhënia e kontratave publike mund të shqyrtohet në shkallë të parë nga ana e organeve të tilla, por Direktivat e Mjeteve Juridike parashikojnë disa garanci:

- Kur organet përgjegjëse për procedurat e shqyrtimit nuk kanë karakter gjyqësor, ato duhet të japin gjithmonë arsyet me shkrim për vendimet e tyre.
- Vendimet e marra nga organet që nuk kanë karakter gjyqësor, duhet të jenë objekt i shqyrtimit gjyqësor ose objekt i procedurës së shqyrtimit nga ana e një organi tjetër, i cili është gjykatë ose tribunal në kuptim të nenit 267 të TFBE-së që është i pavarur si nga autoriteti kontraktues ashtu edhe nga organi i shqyrtimit. Një organ i tillë i pavarur duhet të plotësojë kërkesat e veçanta të nënparagrafit të dytë të nenit 2 (8) të Direktivës 89/665/KEE.⁶ Në thelb, ai duhet të përmbushë të gjashtë kërkesat e paraqitura më lart.

Sistemi i shqyrtimit i prokurimit publik dhe i mjeteve juridike në **Qipro** mund të ndahet në tre elemente: ankesa që i drejtohet autoritetit kontraktues, shqyrtimi jogjyqësor përmes **Autoritetit të Shqyrtimit të Ofertave (TRA)**, dhe shqyrtimi gjyqësor përmes Gjykatës Supreme të Qipros. ART-ja u krijua me kompetencën për të shqyrtuar çdo vendim të marrë nga autoritetet kontraktore para përfundimit të kontratave publike për shkelje të pretenduara të ligjit. Prandaj është ART-ja organ i veçantë i shqyrtimit të prokurimit publik i pavarur nga Qeveria e Qipros. Megjithatë, anëtarët e këtij organi nuk kanë një status që është i krahasueshëm me atë të gjyqtarëve. ART-ja ka pesë anëtarë, përfshirë kryetarin. Çdo person i prekur nga një vendim të ART-së, ose nga çdo vendim i marrë nga autoriteti kontraktues para ose pas përfundimit të kontratës mund të kundërshtojë një vendim të tillë para Gjykatës Supreme të Qipros. Anëtarët e Gjykatës Supreme dhe kryesuesi i saj janë gjyqtarë, dhe statusi i tyre rregullohet me Kushtetutën e Qipros.

Rregullat në bazë të Marrëveshjes së Prokurimit Qeveritar: Kërkesat themelore të procedurave të shqyrtimit të prokurimit publik dhe të mjeteve juridike janë krijuar nga Marrëveshja e Prokurimit Qeveritar (GPA) e vitit 1994 e Organizatës Botërore të Tregtisë (OBT), e cila u rishikua në shkurt të vitit 2014, si dhe nga Ligji Model i Komisionit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtën Tregtare Ndërkombëtare (UNCITRAL), i cili është përditësuar në vitin 2011. Këta tregues të funksionit themelor vendosën themelin mbi të cilin qeveritë mund të ndërtojnë institucione e mjeteve juridike dhe procedurat e shqyrtimit për të trajtuar interesin

⁶ Neni 2(8) i Direktivës 89/665/KEE: “Anëtarët e një organi të tillë të pavarur emërohen dhe largohen nga detyra në të njëjtat kushte si anëtarët e gjyqësorit sa i përket autoritetit përgjegjës për emërimin e tyre, periudhës së tyre të qëndrimit në detyrë, si dhe heqjes së tyre. Të paktën kryetari i këtij organi të pavarur ka të njëjtat kualifikime ligjore dhe profesionale si anëtarët e gjyqësorit. Organi i pavarur i merr vendimet në vijim të një procedure në të cilën të dyja palët janë dëgjuar, dhe këto vendime ligjërisht të detyrueshme sipas mjeteve të përcaktuara nga çdo Shtet Anëtar.”

publik në funksion të përdorimit efikas të shpenzimeve publike dhe, në të njëjtën kohë, për të mbrojtur interesat e aktorëve privatë që marrin pjesë në procedurat e dhënies së kontratave.

Është e dobishme për të nxjerrë në pah se GPA-ja përmban parime të ngjashme në lidhje me organet e shqyrtimit si ato të parashikuara nga legjislacioni i BE-së. Është e vërtetë se jurisprudenca e GJED-së ofron shumë më shumë detaje mbi interpretimin e parimeve të përgjithshme, të zbatueshme në rrethana të veçanta, por ngjashmëritë midis BE-së dhe OBT-së mbi atë se si të trajtohet çështja e organeve të shqyrtimit vlen të theksohet si një shembull i praktikës së mirë, e cila njihet si e tillë në nivel ndërkombëtar.

Sipas GPA-së, furnizuesi duhet të ketë të drejtë të ankohet kundër një vendimi pranë "një autoriteti të paanshëm administrativ apo gjyqësor që është i pavarur nga enti prokurues, prokurimi i të cilit është objekt i kundërshtimit", ndërkohë që "vendimet e një organi të shqyrtimit që nuk është gjykatë, i nënshtrohen shqyrtimit gjyqësor ose do të ketë procedura që garantojnë se:

- (a) Enti prokurues duhet të përgjigjet me shkrim për kundërshtimin dhe duhet t'i tregojë organit të shqyrtimit të gjitha dokumentet përkatëse;
- (b) Pjesëmarrësit në procedurë (më poshtë të quajtur "pjesëmarrësit") kanë të drejtë të dëgjohen para se organi i shqyrtimit të marrë vendim për kundërshtimin;
- (c) Pjesëmarrësit kanë të drejtë të përfaqësohen dhe të shoqërohen;
- (d) Pjesëmarrësit kanë akses në të gjitha procedurat;
- (e) Pjesëmarrësit kanë të drejtë të kërkojnë që procedura të zhvillohet në publik dhe se mund të paraqiten dëshmitarët; dhe
- (f) Organi i shqyrtimit merr vendimet ose jep rekomandimet e veta në kohën e duhur, me shkrim, dhe jep shpjegim të bazës së çdo vendimi ose rekomandimi."⁷

Ankesat administrative pranë autoritetit/subjektit kontraktues

Legjislacioni në disa shtete anëtare parashikon detyrimin ose mundësinë për:

- Të parashtruar ankesë para autoritetit/entitetit kontraktues administrativ që ka kryer shkeljen e pretenduar të ligjit të prokurimit publik; ose
- Të njoftojë autoritetin/entitetin kontraktues për qëllimin e kërimit të shqyrtimit.

Sipas Direktivave të Mjeteve Juridike të dyja këto detyrime janë fakultative.

Mundësia e paraqitjes së një ankese drejtpërdrejt pranë autoritetit kontraktues mund të ofrojë përparësi të caktuara, sidomos në rastet kur arsyeja e mosmarrëveshjes është një gabim i vërtetë dhe i qartë dhe jo një shkelje e qëllimshme e ligjit të prokurimit publik. Ofertuesi mund të shmangë konfrontimin me autoritetin kontraktues për shkak se ky i fundit e ka mundësinë për të korrigjuar gabimin e tij. Kjo zgjidhje mund të jetë mënyra më e shpejtë për korrigjimin e shkeljes, dhe ajo ofron mundësinë duke shmangur shpenzimet e përfshira në procedurat e shqyrtimit.

Edhe pse ky lloj rregulli mund të jetë i dobishëm në praktikë, sipas Direktivave të Mjeteve Juridike **ankesa paraprake para autoritetit/subjektit kontraktues nuk konsiderohet si fazë e parë e procesit të shqyrtimit.**

Disavantazhi është se pritja që një autoritet/entitet kontraktues të vendosë mbi një ankesë, mund të jetë konsumim kohe dhe mund të zgjasë procedurën e përgjithshme të shqyrtimit. Megjithatë, në rast se njoftimi paraprak i është dërguar autoritetit/entitetit kontraktor paralelisht me paraqitjen e kërkesës para organit të shqyrtimit, atëherë nuk ka asnjë detyrim

⁷ Marrëveshja e OBT-së për Prokurimin Qeveritar e vitit 2014 Neni XVII - Procedurat e brendshme të shqyrtimit.

për të pritur për vendimin e autoritetit/entitetit kontraktor. Kjo është arsyeja se përse disa Shtete Anëtare kërkojnë nga operatorët ekonomikë që kërkojnë shqyrtim kuazi-gjyqësor ose gjyqësor, të dërgojnë një kopje të ankesës ose të padisë së tyre vetëm pranë autoritetit/entitetit kontraktor në fjalë. Kjo procedurë i jep vetë autoritetit/entitetit kontraktor mundësinë për të korrigjuar shkeljen para se të hyjë në procedurat e shqyrtimit.

Statusi dhe pavarësia e një organi të specializuar të shqyrtimit

Një kërkesë e Direktivave të Mjeteve Juridike, e cila është gjithashtu një çështje e praktikës më të mirë ndërkombëtare, është pavarësia e organit të shqyrtimit. Kjo kërkesë mund të konsiderohet si një gur themeli për të siguruar rezultate të besueshme për procedurat e mjeteve juridike kundër vendimeve të prokurimit publik.

Çështjet që lidhen me këtë pavarësi duhet të trajtohen në dy nivele:

- Pavarësia e organit të shqyrtimit si institucion;
- Pavarësia e anëtarëve të stafit të organit të shqyrtimit.

Në lidhje me **pavarësinë e institucionit**, pavarësisht nëse organi i specializuar i shqyrtimit ka apo jo status të pavarur ligjor, organi i shqyrtimit duhet të jetë (1) i pavarur nga palët në procedurat e prokurimit – autoritetet/subjektet kontraktore dhe operatorët ekonomik; dhe (2) funksionalisht i pavarur nga qeveria.

Edhe në qoftë se organi i shqyrtimit është teknikisht i pavarur nga autoritetet/subjektet kontraktore, ai është ende pjesë e aparatit shtetëror, dhe si rezultat do të ekzistojë gjithmonë shqetësimi që ai nuk është plotësisht i pavarur nga qeveria. Mosgarantimi i një pavarësie të tillë të veprimit do të çojë në mungesë të besueshmërisë, gjë e cila do të ketë pasoja serioze për sistemin e prokurimit në tërësi dhe për përfitimet e prekshme që një sistem, i cili funksionon mirë, është projektuar për të ofruar. Në qoftë se organi i shqyrtimit nuk është në gjendje që të zbatojë rregullat e prokurimit kundër shkelësve, apo edhe në qoftë se ai perceptohet se nuk është në gjendje për ta bërë këtë, atëherë ofertuesit e dëmtuar nuk do të shohin ndonjë përfitim në paraqitjen e ankesave dhe shkeljet e rregullave nuk do të ndreqen.

Për këto arsye, statusi i organit të shqyrtimit është i lidhur edhe me vendndodhjen e tij në kuadër të hierarkisë qeveritare. Për sa kohë që organi i shqyrtimit është nën mbikëqyrjen e një ministri, është e vështirë të demonstrohet pavarësia e vërtetë e këtij institucioni dhe e stafit të tij, i cili duhet të jetë i mbrojtur nga ndërhyrjet e panevojshme politike. Edhe në qoftë se lidhjet me një ministri janë të kufizuara vetëm në çështjet administrative, një pasojë e pashmangshme e kësaj lidhjeje është që ofertuesit mund të kenë perceptimin se organi i shqyrtimit mbetet pjesë e hierarkisë dhe se pavarësia dhe neutraliteti i tij mund të ndikohen në çdo kohë. Funksioni i shqyrtimit presupozon fuqinë e institucionit për të marrë vendime kuazi-gjyqësore (duke përfshirë dhënien e kompensimit) kundër qeverisë. Është pyetje e hapur nëse një ministri do të ketë fuqinë dhe/ose besueshmërinë për të marrë vendime të tilla.

Si pasojë, zgjidhja më e mirë është me siguri që organi i shqyrtimit të vendoset jashtë një ministrie, mundësisht si një institucion i veçantë. Në çdo rast - edhe në qoftë se nuk është e mundur për të siguruar pavarësi "absolute" – mbajtja e organit të shqyrtimit jashtë çdo pozicionimi hierarkik brenda aparatit qeveritar do të shërbejë kryesisht si një mjet për të ruajtur pavarësinë dhe neutralitetin.⁸

Në përgjithësi, sistemet administrative shtetërore moderne kërkojnë ndarjen e pushteteve në kuadër të administratës për të garantuar llogaridhënien, procesin e rregullt dhe ndershmërinë. Prandaj, ata që janë përgjegjës për hartimin e politikave, interpretimin, zbatimin dhe këshillat nuk janë të njëjta me ata që janë përgjegjës për zbatimin (duke përfshirë funksionin e

⁸ Shih çështjen e GJED-së C-53/03, *Synetairismos Farmakopoion Aitolias & Akarnanias (Syfait)* dhe të tjerët kundër GlaxoSmithKline, në veçanti paragrafët 30 dhe 31.

shqyrtimit dhe të mjeteve juridike). Me shumë pak përjashtime, në të gjitha Shtetet Anëtare, ku janë krijuar organet e specializuara të shqyrtimit, këto institucione kanë një përgjegjësi të qartë dhe të veçantë për të siguruar mjetet juridike. Është shumë e rëndësishme që të sigurohet ndarja e pushteteve dhe e kompetencave në kuadër të sistemit të prokurimit publik në mënyrë që të shmanget çdo konflikt i interesit dhe të krijohet besimi tek sistemi.

Në shumë vende që kanë filluar të ndërtojnë sisteme të reja të prokurimit publik, në fazën e parë organit rregullator (Zyra/Agjencia/Autoriteti i Prokurimit Publik - ZPP/APP) i janë dhënë edhe kompetencat e një organi të shqyrtimit për vendimet e prokurimeve publike.

Në qoftë se organi rregullator ka për detyrë, sipas ligjit, që të japë këshilla për autoritetet/subjektet kontraktore, ai ndonjëherë mund të përballet me këshillat e veta. Kjo situatë do të jetë edhe më e komplikuar, në qoftë se organi do të përfshihej në kontrollin *ex ante* të të gjitha ose të një pjese të procesit të prokurimit. Pasoja është se organi rregullator do të jetë në gjendje që të zgjidhë ankesat në rastet kur vetë ZPP-ja/APP-ja ka pranuar tashmë (ose madje edhe të imponuar) një vendim gjoja të gabuar.

E njëjta mospërputhje mund të vërehet në rastet kur organi i shqyrtimit është direkt i përfshirë në transaksionet e prokurimit, për shembull, kur atij i është caktuar, në mesin e detyrave të tjera, që të veprojë si një organ qendror i prokurimit.

Në raste të tilla, institucioni bëhet *rregullator, i rregulluar, kontrollues dhe gjykatës*, dhe për rrjedhojë konflikti i mundshëm i interesit dhe i abuzimit janë pothuajse të pashmangshëm. Këto marrëveshje nuk janë në përputhje me kërkesat e pavarësisë së organeve të shqyrtimit, dhe shumë vende kanë ndryshuar kuadrin institucional gjatë procesit të vazhdueshëm të reformimit të sistemit të prokurimit publik.

Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet financimit të institucionit. Organi i specializuar i shqyrtimit duhet të jetë i pavarur financiarisht, me buxhetin e vet. Nevojitet buxhet i mjaftueshëm për të garantuar pavarësinë e tij dhe për të siguruar personelin e duhur (duke përfshirë personelin mbështetës administrativ) dhe burime të tjera në mënyrë që organi i shqyrtimit të ofrojë shërbime në nivelin e cilësisë së kërkuar. Zgjidhja më e mirë është për të siguruar financimin me anë të kuadrit ligjor/rregullator. Nëse financimi është i pamjaftueshëm apo edhe në rastin kur financimi është i mjaftueshëm, por është subjekt i vendimeve administrative dhe mund të ndryshohet lehtë, organi i shqyrtimit nuk do të ketë pavarësi të vërtetë për të përmbushur detyrimet e tij.

Organi i shqyrtimit duhet të pajiset me një infrastrukturë të mjaftueshme (p.sh. hapësirë për zyrë, pajisjeve teknike të informatave dhe të komunikimit, bazë të dhënash, dhe trajnim) për të realizuar me sukses punën e tij.

Në lidhje me **pavarësinë e anëtarëve të organit të specializuar të shqyrtimit**, kjo pavarësi është një kërkesë thelbësore për të treguar statusin e pavarur të organit të shqyrtimit si institucion.

Një nga aspektet më të rëndësishme është tërësia e rregullave që rregullojnë procedurat e emërimit dhe të shkarkimit. Mundësia e anulimit të emërimeve të anëtarëve, para skadimit të mandatit të tyre, duhet të jetë e kufizuar vetëm në disa rrethana të posaçme që janë të përcaktuara shumë mirë në ligj. Personi/institucioni që emëron zyrtarisht anëtarët e organit të shqyrtimit, duhet të jetë i njëjtë me atë që ka fuqinë për shkarkimin e tyre (por vetëm në rrethana të veçanta të parashikuara me ligj). Sa më i pavarur të jetë personi/institucioni që ka këto kompetenca ligjore për të emëruar/shkarkuar anëtarët e organit të shqyrtimit, aq më e sigurt do të jetë pozita e tyre dhe, për rrjedhojë, pavarësia e tyre.

Austria

Pavarësia e gjyqtarëve administrativ (anëtarë të përhershëm - *Senatsvorsitzende*) është e garantuar me ligj kushtetues. Anëtarët e përhershëm emërohen nga **Presidenti Federal i Austrisë**; kryetari dhe zëvendësi emërohen për tërë jetën.

Për emërimin ka kërkesa për kualifikim profesional (njohuri specifike të prokurimit publik dhe përvojë juridike). Kryetari, zëvendësi dhe anëtarët e përhershëm duhet të jenë të kualifikuar mirë me të paktën pesë vjet përvojë profesionale në fushën e së drejtës ose në fushën e prokurimit publik.

Sllovenia

Komisioni Kombëtar i Shqyrtimit (KKSh) në Slloveni është një organ i specializuar, i pavarur dhe autonom kombëtar që shqyrton procedurat e shpalljes së fituesit të prokurimit publik, siç përshkruhet në Aktin e Shqyrtimit të Procedurës së Prokurimit Publik. Kryetari dhe katër anëtarët e Komisionit Kombëtar të Shqyrtimit emërohen nga Asambleja Kombëtare, me propozim të Komisionit të Mandateve dhe Zgjedhjeve për një periudhë prej pesë vjetësh me mundësi rizgjedhje.

Kryetari dhe dy nga anëtarët duhet të kenë diplomë universitare në drejtësi dhe një diplomë profesionale që i lejon ata të ushtrojnë profesionin e juristit. Dy anëtarët e tjerë duhet të kenë diplomë universitare në ekonomi apo inxhinieri.

Në çdo rast, anëtarët e organit të shqyrtimit duhet të mbrohen me ligj nga çdo ndërhyrje apo presion që mund të ushtrohet në nivel politik dhe/ose ekzekutiv. Anëtarët e organit të shqyrtimit duhet të ushtrojnë funksionet e tyre me pavarësi të plotë, dhe të gjitha udhëzimet që jepen gjatë kryerjes së detyrave të tyre në emër të një personi tjetër, duhet të ndalohen me ligj.

Pavarësia e anëtarëve të organit të shqyrtimit është parakusht për të siguruar paanshmërinë e tyre, gjë e cila është një parim themelor i të gjitha institucioneve të drejtësisë, kuazi-gjyqësore dhe administrative. Megjithatë, kjo paanshmëri mund të ndikohet nga konfliktet e interesit që nuk mund të shmangen dhe që mund të lindin natyrshëm, pa fajin e dikujt. Për këtë arsye, ligji ose të paktën rregulloret duhet të sigurojnë rregulla për identifikimin dhe zbulimin e konfliktit të interesave dhe të propozojë veprime që mund të merren për t'i shmangur ose zbutur ato. Anëtarët e organit të shqyrtimit duhet të përjashtohen nga pjesëmarrja në procedurat e shqyrtimit sa herë që ata kanë një interes privat në vendim. Për shembull, një anëtar mund të jetë personalisht i përfshirë, ose mund të jetë i afërm i një personi i cili është një nga palët në mosmarrëveshje. Në këtë rast, është e përshtatshme që anëtari të ruajë pozicionin e tij/saj, por të mos marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes për çështjet e atij/asaj. Ky veprim mund të merret duke abstenuar nga një procedurë votimi, duke u tërhequr nga diskutimet e propozimeve përkatëse, dhe duke refuzuar marrjen e dokumenteve ose të informacione të tjera të lidhura me çështjen.

Si rregull i përgjithshëm, anëtarët e organit të shqyrtimit duhet ta kenë të ndaluar që:

- Të kryejnë veprimtari tregtare, duke përfshirë aktivitete të konsulencës, të drejtpërdrejta ose nëpërmjet ndërmjetësve;
- Të jenë anëtarë të një grupi të interesave ekonomike;
- Të jenë anëtar të një partie politike dhe të kryejnë ose të marrin pjesë në aktivitete politike;
- Të ushtrojnë funksione publike ose private, me përjashtim të veprimtarive të mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe/ose krijimit letrar dhe artistik.

Siguria financiare është një tjetër aspekt që duhet të trajtohet me kujdes kur diskutohet pavarësia e anëtarëve të organit të shqyrtimit. Personat në pozita të tilla mund të jenë të ekspozuar në çdo kohë ndaj tundimeve financiare apo tundimeve të llojeve të tjera, dhe ata

duhet të jenë në gjendje t'i përballojnë joshje të tilla. Në ato vende ku niveli i pagave në sektorin publik është përgjithësisht i ulët, është e këshillueshme që të gjendet një zgjidhje ligjore për zbatimin e skemave/rrjeteve të veçanta të pagave në mënyrë që të sigurohet një status i arsyeshëm financiar për anëtarët e organit të shqyrtimit.

Rumania

Anëtarët e Këshillit Kombëtar për Zgjidhjen e Ankesave në Rumani janë nëpunës publikë me një status të veçantë (pavarësi, procedurë të përzgjedhjes dhe emërimit, papajtueshmëritë dhe ndalimet, pagat) dhe përvojë në fushën e ligjit të prokurimit. Anëtarët e Këshillit zgjidhen me konkurs, në bazë të aftësive profesionale dhe reputacionit, dhe emërohen zyrtarisht nga Kryeministri. Ata duhet të kenë diplomë universitare dhe, së paku, dy vjet përvojë profesionale në fushën e prokurimit publik. Të paktën gjysma e anëtarëve të Këshillit duhet të jenë juristë të kualifikuar.

Në lidhje me nivelin e tyre të shpërblimit, anëtarët e Këshillit janë barazuar me funksionin e sekretarit të përgjithshëm të qeverisë.

Çështje të tjera të rëndësishme praktike

Nuk është e mjaftueshme që thjesht të përshkruhet "në letër" lloji i organit të shqyrtimit që duhet të krijohet dhe rregullat e përgjithshme që duhet të miratohen. Ekziston një numër detajesh shtesë që duhet të trajtohen me kujdes. Këto detaje nuk janë dhënë shprehimisht në Direktivat e Mjeteve Juridike, por ato kanë një ndikim potencial në parimet e përgjithshme të mosdiskriminimit, efektivitetit dhe transparencës.

Lidhur me **respektimin e parimit të mosdiskriminimit**, të kuptuarit e përgjithshëm është se aksesin në mjetet juridike duhet të jetë i hapur për të gjithë operatorët ekonomikë pa diskriminim, veçanërisht mbi bazën e kombësisë.

Për më tepër, parimi i ekuivalencës kërkon që, kur mjetet e veçanta juridike kanë të bëjnë me zbatimin e rregullave të BE-së, kushtet për zbatimin e këtyre mjeteve juridike duhet të jenë "jo më pak të favorshme" se kushtet e aplikimit të mjeteve të ngjashme juridike për zbatimin e rregullave të brendshme. Për këtë arsye, rregullat në lidhje me aksesin në një organ të shqyrtimit, tarifrat, afatet kohore dhe dëshmitë që do të paraqiten nuk duhet ta bëjnë të pamundur ose tepër të vështirë ushtrimin e të drejtave që jepen me ligj.⁹

Për shembull, kostot lidhur me procedurat e shqyrtimit dhe të mjeteve juridike nuk duhet të jenë të rëndësishme, pasi kostot e larta mund të shihen si një dekurajim për paraqitjen e ankesave nga ana e ofertuesve. Shumica e shteteve anëtare, në mënyrë që të zvogëlojë rrezikun e abuzimit përmes ankesave mashtruese, vendosin një tarifë fillestare për paraqitjen e ankesës. Megjithatë, tarifrat që paguhen për organet e shqyrtimit të shkallës së parë, janë në çdo rast më të ulëta se ato që paguhen për ankesën ose për shqyrtimin që bëhet nga organet e shkallës së fundit. Tarifrat duhet të jenë proporcionale, me synim reduktimin e nxitjes së parashtrimit të ankesave mashtruese ose të pabazuara, ndërsa, në të njëjtën kohë, të mos kthehen në dekurajim për paraqitjen e ankesave të justifikuar dhe të mos e kufizojnë aksesin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në procedurat e shqyrtimit dhe të mjeteve juridike.

Është e natyrshme që në ligj të parashikohen elementet më të rëndësishme të cilat duhet të përfshihen ose t'i bashkëngjiten ankesës. Megjithatë, kërkesat në lidhje me provat nuk duhet të jenë të tepruara, ose të pamundura për t'u përmbushur. Operatorët ekonomikë nganjëherë mund të mos sigurojnë dokumente/informacione të caktuara apo mund të mos respektojnë me saktësi formatin e kërkuar nga disa gazeta. Në raste të tilla, është e këshillueshme që këtyre operatorëve ekonomikë t'u jepet mundësia për të përfunduar dosjen.

⁹ Shih çështjen e GJED-së C-327/00, *SantexSpAv Unità Socio Sanitaria Locale n. 42 di Pavia*.

Në lidhje me **respektimin e parimit të efektivitetit**, mjetet juridike duhet të kenë autoritet të mjaftueshëm (pushtet zyrtar) për të siguruar respektimin e rregullave të prokurimit publik, dhe shqyrtimi duhet të jetë sa më i shpejtë që të jetë e mundur. Për të arritur këtë objektiv, organi funksional i shqyrtimit është parakusht. Për të ushtruar detyrat e tij, organizimi, financimi, personeli dhe autoriteti i organit të shqyrtimit duhet të jenë të mjaftueshme dhe në përputhje me përgjegjësitë e tij.

Duhet të përcaktohen norma të qarta dhe të detajuara me ligj ose, të paktën, në nivelin e rregulloreve të zbatimit që trajtojnë kërkesat procedurale dhe rregullat e procesit të shqyrtimit. Çështjet e tjera, të tilla si mënyra e ndarjes së çështjeve ndërmjet anëtarëve të organit të shqyrtimit (shpërndarja e çështjeve është ndoshta zgjidhja më e mirë, ku korrupsioni është një kërcënim serioz), mënyrat e shmangies së konfliktit të interesave, si dhe kualifikimet që kërkohen për t'u bërë anëtar (studimet, përvoja, njohuritë dhe aftësitë e tjera të veçanta) gjithashtu duhet të rregullohen në mënyrë të qartë. Është e rëndësishme që të garantohet siguri ligjore, nëse i tërë organi i shqyrtimit duhet të marrë vendime për çështjet apo nëse do të ngrihen trupa për të marrë vendime. Nëse opsioni i dytë është i preferuar, atëherë duhet të tregohet numri i anëtarëve të secilës trupë.

Duhet të miratohen rregulla procedurale për të siguruar shpejtësinë e procedurave, për shembull, duke përcaktuar kornizat maksimale kohore për vendimet e organit të shqyrtimit.

Të gjitha normat e lartpërmendura përfitojnë jo vetëm nga krijimi i një organi funksional të shqyrtimit, por janë edhe në interes të të gjitha palëve të interesuara - autoritetet/subjektet kontraktore, si dhe operatorët ekonomikë. Këto norma shprehin qartë se cilat janë rregullat dhe se çfarë mund të pritet të ndodhë gjatë procedurës së shqyrtimit.

Kapacitetet e organit të shqyrtimit duhet të jenë të përshtatshme për t'u marrë me numrin e pritshëm të ankesave, dhe këto kapacitete duhet të forcohen gjatë kohës në përputhje me zhvillimin e përgjithshëm të të gjithë sistemit. Në aspektin e burimeve njerëzore në veçanti, kapaciteti administrativ do të reflektohet në madhësinë e stafit, përbërjen e stafit, dhe kualifikimin e tyre arsimor.

Nëse institucionet e shqyrtimit kanë mungesë të vazhdueshme personeli, atëherë kapacitetet e burimeve njerëzore nuk do të jenë të mjaftueshme për të kryer detyrat e tyre në mënyrë efektive. Numri i anëtarëve të organit të shqyrtimit duhet të përcaktohet duke marrë në konsideratë disa faktorë të rëndësishëm, të tillë si:

- Gama e detyrave të caktuara të organit të shqyrtimit, duke përfshirë jo vetëm kompetencat e dhëna, por edhe shtrirjen e sistemit të shqyrtimit;¹⁰
- Numri i autoriteteve/subjekteve kontraktore në vend;
- Kultura e shqyrtimit, duke përfshirë edhe mentalitetin lokal dhe prirjen e operatorëve ekonomik për të parashtruar ankesa kundër vendimeve të autoriteteve/subjekte kontraktore;
- Afatet kohore të parashikuara në ligj për të vendosur mbi një mosmarrëveshje;
- Numri i anëtarëve të organit të shqyrtimit që, sipas ligjit, duhet të merren me çdo çështje;
- Mbështetja që mund të ofrohet për anëtarët e organit të shqyrtimit nga stafi teknik dhe administrativ i institucionit.

Përgatitja arsimore e personelit që punon në organin e shqyrtimit është gjithashtu e rëndësishme, pasi anëtarët e tij jo vetëm që duhet të kenë njohuri të mira rreth çështjeve të prokurimit publik, por gjithashtu duhet të jenë të aftë për vlerësimin e provave dhe hartimin e

¹⁰ Në grupin më të madh të shteteve anëtare të BE-së, sistemi i shqyrtimit vlen njëlloj për kontratat mbi dhe nën kufijtë monetarë të Direktivave të Prokurimit Publik 2004/17/KE dhe 2004/18/KE. Për më shumë detaje, shih *nga Sistemet e Shqyrtimit të Prokurimit Publik dhe të Mjeteve Juridike në Bashkimin Evropian* (Dokumenti i SIGMA-s Nr. 41).

vendimeve të argumentuara. Emërimi i personave për të kryer funksionet e shqyrtimit në kuadër të reformimit të sistemit të prokurimit nuk do të thotë se ata janë nga vetë ky fakt kompetent për t'i kryer këto funksione. Krijimi i një organi (të ri) të shqyrtimit zakonisht do të kërkojë përpjekje për rritjen e kapaciteteve, gjë e cila do të përfshijë trajnim intensiv, veçanërisht në fillim të veprimtarisë së institucionit, por edhe në vitet e mëvonshme, përmes pjesëmarrjes në programet e arsimit të vazhdueshëm.

Një çështje e ndjeshme është edhe përcaktimi nëse organi i shqyrtimit duhet të marrë parasysh vetëm përmbajtjen e ankesës dhe ta kufizojë shqyrtimin ekskluzivisht në pretendimet e paraqitura nga operatorët ekonomikë apo nëse duhet të hetojë më gjerë, duke pasur parasysh të gjithë dokumentacionin e prokurimit, në mënyrë që të përcaktohet nëse ka ndodhur apo jo një shkelje e madhe e ligjit.

Nuk ka kërkesa të BE-së për hetime kryesisht që ato të kryhen nga institucioni i shqyrtimit. Disa vende kanë dispozita të tilla në legjislacionin e tyre, por shumë prej tyre kanë planifikuar ta braktisin këtë kërkesë, pasi rezultati i këtyre dispozitave nuk ka qenë gjithmonë pozitiv në praktikë. Në shumë raste, ankuesit e kanë transferuar barrën e hetimit tek organi i shqyrtimit, gjë e cila ka çuar në procedurat e gjata dhe të kushtueshme.

Mbështetja e jashtme e rëndësishme e anëtarëve të organit të shqyrtimit mund të sigurohet nëse ata do të kishin akses në përdorimin e ekspertizës së jashtme për të shqyrtuar aspektet teknike të një rasti. Si rregull i përgjithshëm, ekspertët duhet të kenë njohuri të specializuara në një fushë të veçantë, dhe detyra e tyre duhet të jetë e përqendruar në dhënien e ndihmës së paanshme për organin e shqyrtimit në lidhje me çështjet e veçanta, të cilat janë kryesisht teknike apo financiare. Si ankuesi ashtu edhe autoriteti kontraktues duhet të lejohen që të paraqesin (një) opinion (e) eksperti. Përveç kësaj, organi i shqyrtimit mund të emërojë ekspertin e vet, i cili duhet të jetë i paanshëm dhe i pavarur nga palët dhe nga çdo ndikim tjetër. Nëse këshilla e dhënë nuk duket e arsyeshme, atëherë organi i shqyrtimit mund ta refuzojë atë, mund të emërojë një tjetër ekspert, ose mund të miratojë gjetjet e ekspertëve të palëve, nëse është e aplikueshme.

Në thelb, anëtarët e organit të shqyrtimit nuk janë të detyruar që të miratojnë opinionin e ekspertëve, por megjithatë ky opinion mund të mbajnë një peshë të konsiderueshme kur të merret një vendim. Prandaj ai nuk duhet të hidhet poshtë në mënyrë arbitrare.

Sa për **respektimin e parimeve të sigurisë ligjore dhe transparencës**, një nga objektivat më të rëndësishëm të organit të shqyrtimit është garantimi i vendimeve të qëndrueshme, të cilat ai duhet t'i vërë në dispozicion të publikut.

Kushti i parë është që të ketë procedura të qarta dhe transparente që sigurojnë zbatimin koherent të ligjit. Së dyti, secila palë duhet të ketë të drejtë të jetë e informuar për zhvillimin e procedurës në mënyrë që të jetë në gjendje që të përgatisë në mënyrë adekuate argumentet e saj. Së treti, palët duhet të kenë të drejtë të informohen për arsyet e vendimit të organit të shqyrtimit, duke përfshirë argumentet që kanë përcaktuar vlerësimin e provave dhe vlerësimet e çështjeve ligjore që kanë qenë të rëndësishme për vendimin.

Publikimi i vendimeve të organit të shqyrtimit në faqen e tij të internetit është një mjet efektiv për t'i ndihmuar anëtarët e tij që të sigurojnë përputhshmërinë në rritje të vendimeve të institucionit me vendimet e mëparshme për raste të ngjashme dhe të shmangin vendimet kundërshtuese gjatë interpretimit të ligjit. Për më tepër, kjo mund të shërbejë si një instrument i vlefshëm për ndarjen e ekspertizës së organit të shqyrtimit me aktorë të tjerë kyç në sistem. Autoritetet/subjektet kontraktore dhe operatorët ekonomikë do të përfitojnë nga kjo mënyrë e shkëlqyer për të promovuar zgjidhje të ankesave të ndryshme të zgjidhura nga institucioni dhe interpretimin e tij të problemeve të ndryshme me të cilat sistemi i prokurimit është duke u përballur.

Aksesi i lehtë në të dhënat e rëndësishme është i nevojshëm për rritjen e efikasitetit të mekanizmit të "ndarjes" dhe për mundësimin e kërkimit të shpejtë për rastet që plotësojnë kriteret specifike. Për këtë arsye, botimi i vendimit në formë të papërpunuar (p.sh., një dokument në PDF) nuk do të mjaftojë për të garantuar interpretim të qëndrueshëm dhe zbatimin e ligjit. Do të jetë e vështirë për praktikuesit e prokurimit publik për të gjetur zgjidhje të shpejtë për problemet juridike, siç pasqyrohet në këto vendime individuale, pa i lexuar të gjitha ato.

Zgjidhja më e mirë është që të zhvillohet **një bazë të dhënash e vendimeve, duke përfshirë edhe objektet e kërkimit** për probleme të veçanta ligjore, si një mjet mbështetjeje për praktikuesit në aktivitetet e tyre të përditshme të prokurimit dhe gjithashtu si një instrument për anëtarët e organit të shqyrtimit që të sigurojë marrjen e qëndrueshme të vendimeve. Përveç kësaj, organi i shqyrtimit duhet të publikojë analiza të problemeve më të zakonshme ligjore që hasen në procedurat e prokurimit, duke siguruar të dhëna se si të trajtohen këto probleme në praktikë (p.sh., kriteret e kualifikimit, kriteret e shpalljes së fituesit, përdorimi i specifikimeve teknike dhe i ofertave anomalisht të ulëta).

Informacion i mëtejshëm

Botime

SIGMA (2007), *Sistemet e Shqyrtimit të Prokurimit Publik dhe i Mjeteve Juridike në Bashkimin Evropian*, Dokumenti i SIGMA-s Nr. 41, Botimet e OECD-së, Paris,

http://www.sigmaweb.org/publications/Alb_SP41_07.pdf

Udhëzimet e Prokurimit Publik

<http://www.sigmaweb.org/publications/key-public-procurement-publications.htm>

SIGMA (2016), *Mjetet Juridike*, Udhëzimi 12, Botimet e OECD-së, Paris.